

Praktikant në Burime Njerëzore (me pagesë)

TRAININGS
RECRUITMENTS
CONSULTANCY

eppc

EPPC Albania në kuadër të zgjerimit të aktiviteteve ofron mundësinë e një **praktike në Departamentin e Burimeve Njerëzore**. Nëpërmjet kësaj praktike, praktikanti do të ketë mundësi të përfitojë përvojë profesionale nëpërmjet kontributit në proceset e punës së kompanisë, duke patur mbështetje intensive nga Departamenti i Burimeve Njerëzore.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Mirëmban dokumentacionin fizik dhe elektronik në lidhje me departamentin përkatës;
- Detyra administrative mbështetëse të departamentit;
- Suporton departamentin me përkthime sipas nevojës.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Student/Diplomuar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, **Dega Anglisht - Italisht;** (e preferueshme)
- Përdorimi i **MS Office. Excel-i është domosdoshmëri;**
- Të ketë qëndrim pozitiv dhe frymë bashkëpunuese në grup;
- **Të zotërojë shkëlqyeshëm gjuhën angleze;**
- Të jetë person korrekt, i besueshëm dhe i organizuar.

Të dhënat:

| | |
|---------------------------|--|
| Pozicioni: | Praktikant në Burime Njerëzore; |
| Vendndodhja: | Zona e Liqenit, Tiranë; |
| Orari: | 15 - 20 orë në javë; |
| Raporton: | Drejtuesi i Departamentit të Burimeve Njerëzore; |
| Aplikimet mbyllen: | 28.11.2017. |

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese (*dëshmi të mbrojtjes së gjuhës së huaj angleze*) duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail^{-it}:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.

Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.